



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

R R E G U L L O R E

“PËR MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR GJATË GJENDJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19”

Neni 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i rregullores COVID-19, është organizimi dhe funksionimi i punës në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (këtu më poshtë Fondi), për të garantuar vijimësinë normale të punës dhe kushte të përshtatshme mbrojtëse, për reduktimin e transmetimit të COVID-19.
2. Objekti i rregullores është përcaktimi i rregullave, procedurave standarde të punës të harmonizuara, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë, (OBSH).
3. Fondi, brenda fushës së tij të veprimit siguron funksionimin normal të institucionit dhe kryerjen e rregullt të të gjitha veprimtarive institucionale, duke garantuar zbatimin e masave dhe udhëzimeve të sigurisë, të rekomanduara nga Instituti i Shëndetit Publik dhe nga kjo rregullore.

Neni 2

ORGANIZIMI I PUNËS NË INSTITUCION GJATË PERIUdhËS SË GJENDJES SË EPIDEMISË COVID-19

1. Gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë COVID-19, Fondi realizon veprimtarinë e tij nëpërmjet kombinimit të punës në ambientet e institucionit dhe të punës në distancë online/virtualisht.
2. Për realizimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, Fondi/DRF përcaktojnë në mënyrë të detajuar dhe të qartë grafikun e punonjësve që do të punojnë në ambientet e

institucionit dhe të atyre që do të punojnë në distancë online/virtualisht. Grafiku miratohet nga titullari i institucionit/DRF.

3. Në përcaktimin e numrit të punonjësve që do të punojnë në ambientet e institucionit, duhet mbajtur në konsideratë detyrimi i respektimit të largësisë prej 1.5 metrash ndërmjet punonjësve.
4. Përcaktimi i punonjësve që do të punojnë fizikisht/online/virtualisht të bazohet në:
 - a. Evidentimin e rasteve të punonjësve me patologji të ndryshme kronike, të cilët janë më të rrezikuar ndaj infektimit me COVID-19.
 - b. Evidentimin e punonjësve që kanë në kujdestari fëmijë deri në moshën 14-vjeç.Për rastet e parashikuara më sipër, përpara miratimit të grafikut, Drejtori i Drejtorisë/Përgjegjësi i sektorit të konsultohet me punonjësit me qëllim që të mundësohet realizimi i detyrave të tyre online/virtualisht.
5. Punonjësit që do të kryejnë detyrat në ambientet e Fondit/DRF, të respektojnë të gjitha rregullat dhe masat mbrojtëse personale (MMP) për realizimin e detyrave të tyre funksionale, si dhe udhëzimet e përcaktuara nga MSHMS dhe ISHP.
6. Puna në distancë online/virtualisht ka të njëjtën kohëzgjatje kohore, sikundër edhe paraqitja fizike në ambientet e punës së institucionit.
7. Gjatë punës në distancë online/virtualisht, punonjësit të vënë në dispozicion të eprorëve dhe të sektorit të burimeve njerëzore dhe trajnimeve, informacionin kontaktues të tyre dhe janë të aksesueshëm online/virtualisht, gjatë gjithë orarit zyrtar të punës.
8. Drejtori i Drejtorisë/Përgjegjësi i sektorit të:
 - a. Përcaktojë qartë afatet kohore të punës në distancë të punonjësit si dhe kohën sesa shpejt ai i përgjigjet elektronikisht nevojave, kërkesave, detyrave të ngarkuara në zbatim të planeve të punës.
 - b. Monitorojë punonjësit në distancë online/virtualisht për punën që ata kryejnë, nëpërmjet kontaktit virtual të detyrueshëm, bashkëpunimit në grup, raportimeve ditore/javore/mujore.
9. Punonjësit që punojnë në distancë online/virtualisht u përgjigjen thirrjeve të Drejtorit të Drejtorisë/Përgjegjësit të sektorit, një herë në ditë me qëllim, që të informohen dhe të informojnë rreth statusit të realizimit të detyrës së ngarkuar. Atyre, u sigurohet mundësia për të shkëmbyer informacionin në rrugë elektronike.
10. Fondi siguron, që punonjësit që punojnë në distancë online/virtualisht të dinë se si të marrin ndihmë/mbështetje apo informacion teknik në lidhje me punën në distancë, në të gjitha rastet kur kjo është e nevojshme, duke kërkuar mbështetjen e punonjësit IT të Fondit/DRF.

Neni 3

OFRIMI I SHËRBIMEVE NDAJ PUBLIKUT

1. Fondi garanton ofrimin e shërbimeve ndaj publikut gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, nëpërmjet planit të masave për të minimizuar kontaktin midis qytetarëve dhe punonjësve duke shmangur grumbullimin e tyre në sportelin e Fondit/DRF dhe në ambientet e tjera të brendshme.
2. Plani i masave përfshin rastet e ofrimit të shërbimeve online/virtualisht përdorimin e mjeteve të komunikimit elektronik duke nxitur qytetarët/pacientët, të përdorin platformat online të ofrimit të kujdesit shëndetësor apo marrjes së çdo informacioni shëndetësor.
3. Punonjësit e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, zbatojnë udhëzimet e MSHMS dhe të ISHP për ndalimin e përhapjes së COVID-19.

Neni 4


PUNA NË TERREN

1. Punonjësit e Fondit respektojnë rregullat e distancimit fizik dhe përdorin mjetet mbrojtëse PERSONALE (MMP) gjatë udhëtimit dhe punës në terren.
2. Për punonjësit e Fondit të cilët zbatojnë planet e punës në terren, gjatë kohës kur transporti publik nuk është funksional, transporti i tyre organizohet me makinat e institucionit, me makinat e tyre personale gjithmonë duke respektuar Udhëzimet e MSHMSH dhe ISHP.
3. Drejtorët e drejtorive/përgjegjësit e sektorëve që kryejnë punë në terren, mbajnë evidenca të hollësishme të punës në terren të punonjësve që kanë në varësi, të dhëna të cilat mund t'i shërbejnë autoriteteve të shëndetit publik.

Neni 5

SIGURIMI I INFRASTRUKTURËS SË NEVOJSHME PËR PUNËN ONLINE

1. Fondi, DIAS duhet të nxisë dhe përmirësojë përdorimin e mjeteve në funksion të punës online, duke identifikuar metoda të thjeshta për përdorim nga të gjithë punonjësit, në varësi të llojit të detyrave që ata duhet të përmbushin.
2. Me qëllim respektimin e distancimit fizik, por edhe rritjen e produktivitetit gjatë punës, Fondi/DRF të përdorin mjetet e punës online, si:
 - e-mail zyrtar, i cili mund të konfiguruar për t'u përdorur në telefon ose edhe në web nëpërmjet link-ut <https://owa.e-albania.al/owa>;
 - Webex Meeting platformë e cila mundëson komunikimin në kohë reale, organizmin e video konferencave në mënyrë që punonjësit të komunikojnë me njëri-tjetrin.




3. Për të garantuar një përdorim sa më efektiv të mjeteve të punës online, punonjësit e Drejtorisë së Informatikës dhe Analizës Statistike sigurojnë instalimin e tyre dhe informacionin e nevojshëm për përdorim nga ana e të gjithë punonjësve. Ky informacion përcillet përmes e-mailit ose videove tutoriale në rast kërkese apo nevojë.




Neni 6

MINIMIZIMI I RISKUT TË INFEKTIMIT NGA COVID-19 GJATË MBLEDHJEVE

1. Punonjësit brenda Fondit udhëzohen t'i zhvillojnë mbledhjet e tyre ose aktivitetet e tjera të kësaj natyre, të tilla si: mbledhje, takime, trajnime profesionale etj, duke përdorur platformën e komunikimit online.
2. Nëse nga Kryetari i Grupit të Punës vlerësohet se është i nevojshëm takimi ballë për ballë, i cili nuk mund të zëvendësohet nga një video konferencë, atëherë përpara organizimit të mbledhjes të merren masat e nevojshme për minimizimin e rrezikut të infektimit nga COVID-19, konkretisht:



- a) Të vlerësohet nëse mund të reduktohet numri i pjesëmarrësve në mbledhje.
- b) Të këshillohen paraprakisht pjesëmarrësit, që nëse nuk ndjehen mirë ose nëse kanë simptoma të ngjashme me ato të infektimit nga COVID-19, të mos bëhen pjesë e mbledhjes.
- c) Të garantoohen materialet e nevojshme higjeno-sanitare, si: sapun i duarve, dezinfektantët me bazë alkooli, letër të pastrimit të duarve ose peshqir me një përdorim për pastrimin e sipërfaqeve, maska mbrojtëse, kosha të mbyllur për eliminimin e mbetjeve.



- d) Të sigurohen që të kenë kontaktet e të gjithë pjesëmarrësve, si: numër telefoni, e-mail dhe adresa ku ata janë duke qëndruar. Të informohen pjesëmarrësit se të dhënat e tyre do t'i përcillen autoriteteve të shëndetit publik, nëse ndonjë prej tyre preket nga sëmundja infektive COVID-19.
- e) Të përcaktohen vendet ku do të ulen pjesëmarrësit në mënyrë që të ruhet distanca prej së paku 1.5 metra nga njëri –tjetri.
- f) Të përcaktohet masa gadishmërisë, nëse ndonjë nga pjesëmarrësit nuk ndjehet mirë gjatë takimit ose shfaq simptoma të infektimit të mundshëm.

3. Gjatë zhvillimit të mbledhjes, të:
- Udhëzohen pjesëmarrësit për larjen e rregullt të duarve ose përdorimin e një dezinfektanti me bazë alkooli.
 - Sigurohet që pjesëmarrësit në takim të përdorin maska dhe t'i udhëzojnë ata të mbulojnë fytyrën e tyre me këndin e bërrylit ose një pecetë një përdorimëshe nëse kolliten ose



teshtijnë.

- c. Orientohen pjesëmarrësit për këshillat dhe informacionin e nevojshëm të kujdesit shëndetësor.
- d. Marrin masat për ajrosjen e herëpashershme të ambientit ku zhvillohet mbledhja.

Neni 7

SIGURIMI I KUSHTEVE TË DUHURA HIGJENO-SANITARE NË AMBJENTIN E PUNËS

1. Në përputhje me udhëzimet e dhëna nga MSHMS dhe ISHP, Fondi siguron infrastrukturën dhe kushtet e duhura higjeno- sanitare, me qëllim kufizimin e përhapjes së COVID-19 në mjediset e punës, siç janë:
 - a. Sigurimi i vazhdueshëm i elementëve të higjenës ku përfshihen: sapuni i duarve, dezinfektantët me bazë alkooli, letër e pastrimit të duarve, koshat e mbyllur për eliminimin e mbetjeve.
 - b. Pastrimi i vazhdueshëm i sipërfaqeve dhe elementëve të tjerë të vendit të punës. Dezinfektimin e mjedisit të punës, pastrimin përpara hapjes dhe pas mbylljes së procesit të punës, sidomos të tavolinave, telefonave, tastierave të kompjuterave dhe çdo hapësire



ku punonjësi ka kontakt me duart, si dhe ajrimin minimalisht 1 herë në ditë. Pastrimi, dezinfektimi korridoreve, tualeteve, dezinfektimi dorezave të dyerve të çdo zyre si dhe parruket e shkallëve.

2. Punonjësit e Fondit zbatojnë rregullat e mëposhtme:
 - a. Aplikojnë larjen e duarve dhe/ose përdorimin e dezinfektantëve.
 - b. Respektojnë Udhëzimet e MSHMS dhe ISHP.
 - c. Respektojnë masat e distancimit social dhe fizik duke ruajtur distancën të paktën 1.5 metra nga njëri – tjetri.
 - d. Vendosin maska mbrojtëse personale.
 - e. Punonjësit që kanë shenja klinike, qëndrojnë në shtëpi, të vetëkarantinuar si dhe njoftojnë Drejtorin e Drejtorisë/Përgjegjësin e Sektorit, ata për çdo shqetësim kontaktojnë me Mjekun e Familjes.
3. Punonjësit që riadhesohen në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 të vetëkarantinohen për një periudhë 14 (katërmëdhjetë) ditore, sipas përcaktimeve në Urdhrin nr. 292 Prot. datë 04.05.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për mënyrën e vetëkarantimit të personave që riadhesohen”.



Neni 8

AKSESI NË RRJETIN DHE SISTEMIN ELEKTRONIK TË FONDIT

1. Fondi/DIAS vendos nëse punonjësi ka nevojë për akses në rrjetin e brendshëm të institucionit apo thjesht hyrje/përdorim të adresës elektronike zyrtare.

- 2 Në rastin e lejimit të aksesit në shërbimin e adresës elektronike nga punonjësi, adresa elektronike zyrtare të aksesohet nga çdo punonjës nga faqja elektronike e Fondit në adresën www.fsdksh.gov.al

Neni 9

DISPOZITA TË FUNDIT

- 1 Rregullorja për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë institucionale publikohet në faqen zyrtare të institucionit.
- 2 Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë Qendrore dhe Drejtorët në institucionet e varësisë së Fondit janë përgjegjës për mbikqyrjen njoftimin e punonjësve, për njohjen e rregullores nga ana e tyre si dhe gjatë pandemisë Covid - 19.